

VENDIM
Nr.836, datë 28.12.2005

**PËR PAGESËN E DIFERENCAVE TË PENSIONEVE PËR PERSONAT, QË PËRFITOJNË
NGA LIGJI NR.7514, DATË 30.9.1991 “PËR PAFAJËSINË, AMNISTINË DHE
REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Likuidimin e shumave dhe të diferencave të pensioneve, për periudhat e kaluara, për personat, që përfitojnë nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, të llogaritura në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondet e programuara në buxhetin e vitit 2005, zëri “Financime për programe të tjera”, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha